



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA  
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 475 Dt. 13.09.2021

PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Prishtinë, 13.09.2021

## Doracak për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese në LED për klubet e ArtMotion Superligës së Kosovës në basketboll

Me qëllim të rritjes së vlerës së garës së ArtMotion Superligës së Kosovës, por edhe rritjes së vlerës dhe përkrahjes së klubeve anëtare të saj, Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) ka vendosur që të sigurojë praninë e sistemit më të avancuar të reklamimit LED në të gjitha palestrat sportive ku zhvillohen ndeshjet e elitës së basketbollit kosovar.

Si rrjedhojë, Federata e Basketbollit të Kosovës do të merr përsipër pagesën e shpenzimeve të sistemit LED në emër të klubeve anëtare të ArtMotion Superligës së Kosovës, ndërsa ekipet duhet të sigurojnë hapësirën në palestër për vendosjen e tyre dhe të asistojnë për vendosjen e sistemit LED me kapacitetet e tyre njerëzore, si dhe të garantojnë qasje të papenguar nëpër palestra dhe stabilimente të tyre për ekipin realizues të kontraktuar për vendosjen e sistemeve LED.

Ekipet nikoqire do të jenë përgjegjëse për hyrjen dhe daljen e sigurt të ekipeve realizuese dhe për sigurinë e sistemeve të kushtueshme LED gjatë kohës së vendosjes në palestrën nikoqire. Ekipet pjesëmarrëse do të jenë përgjegjëse për dëmtimin e sistemeve LED nga cilido anëtar apo tifoz i tyre.

Vendosja e sistemeve të reklamimit LED për të gjitha ndeshjet e ArtMotion Superligës përbën krijimin e një standardi të ri organizativ për garën e nivelit elitare.

Për të realizuar këtë sipërmarrje madhore dhe të rëndësishme për imazhin dhe nivelin e basketbollit elitare në vendin tonë, Federata e Basketbollit të Kosovës do të caktojë një person kontaktues për reklamën, të cilat klubet do t'i vendosin në sistemin LED, kurse të njëjtën gjë duhet ta bëjnë edhe klubet, pra ta caktojnë një person kontaktues për të qenë në kontakt të vazhdueshëm me personin e emëruar nga FBK. Ekipet e ArtMotion Superligës duhet t'i dërgojnë më së largu dy ditë para ndeshjeve reklamën e tyre që do të vendosin në sistemin LED, në formatin grafik të kërkuar nga FBK dhe operatori i kontraktuar për këtë qëllim nga FBK. Klubeve të ArtMotion Superligës së Kosovës do t'u ndahet tabela orientuese e reklamimit në sistemin LED, në të cilën duhet të identifikojnë të gjithë sponsorët që do të reklamohen në të.

Hapësira reklamuese në sistemin LED do të ndahet mes ekipeve nikoqire dhe FBK, në proporcionin e përcaktuar nga FIBA për garat elitare të saj. Klubet nikoqire do të kenë të drejtë të vendosjes së deri në 16 logo të sponsorëve të tyre, përfshirë edhe logot e komunave përkatëse në rast se të njëjtat përkrahin veprimtarinë e klubeve, ndërsa FBK ruan të drejtën e vendosjes së 8 reklamave të veta pas çdo rotacioni të 16 reklamave të ekipit nikoqir. Reklamën do të jenë të ndara mes vete me logot përkatëse të FBK-së dhe klubit nikoqir.

### Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333  
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku  
C3 (Faza 2), Rr. Radovan  
Zogoviq, Hyrja 7  
10000 Prishtinë, Kosovë



RUGOVE GROWZILLAS



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

### Shembull i një rotacioni në LED – 28 pozicione

1. Intro klubi nikoqir	2. Sponsor	3. Intro FBK
4. Sponsor	5. Sponsor	6. Sponsor FBK
7. Sponsor	8. Sponsor	9. Sponsor FBK
10. Sponsor	11. Sponsor	12. Sponsor FBK
13. Sponsor	14. Sponsor	15. Sponsor FBK
16. Sponsor	17. Sponsor	18. Sponsor FBK
19. Sponsor	20. Sponsor	21. Sponsor FBK
22. Sponsor	23. Sponsor	24. Sponsor FBK
25. Sponsor	26. Outro klubi nikoqir	27. Sponsor FBK
		28. Outro FBK

#### Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333  
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku  
C3 (Faza 2), Rr. Radovan  
Zogoviq, Hyrja 7  
10000 Prishtinë, Kosovë

Me respekt,

Elvira DUSHKU  
Sekretare e Përgjithshme

Federata e Basketbollit të Kosovës



RUGOVE GROWZILLAS